



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në bazë të nenit 48, paragrafi (1), pika 3) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/21) dhe pika 12, paragrafi 1 nga Vendimi i përmbajtjes, mënyrës, formës dhe afateve të dorëzimit të të dhënave dhe informacioneve të statistikës së pagesave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 12/23), guvernatori i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, miratoi

UDHËZIM

për dorëzim të të dhënave dhe informacioneve të statistikës së pagesave

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Me këtë udhëzim përcaktohet lloji dhe përshkrimi i të dhënave dhe informacioneve të statistikës së pagesave dhe mënyra e dorëzimit të tyre te Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut (më tutje në tekst: Banka Popullore).
2. Shprehjet e caktuara të përdorura në këtë vendim kanë këto kuptime:
 - "Pages aktiv" janë përdoruesit e shërbimeve të pagesave të cilët gjatë vitit kalendarik për të cilin raportohet kanë iniciuar të paktën një transaksion të pagesave nëpërmjet internetit dhe/ose vendim për pagesë celulare.
 - "Aksesorë aktiv" janë përdoruesit e shërbimeve të pagesave të cilët gjatë vitit kalendarik për të cilin raportohet të paktën një herë kanë bërë kontrollim në gjendjen dhe ndryshimet e llogarisë nëpërmjet internetit dhe/ose vendim për pagesë celulare.
 - "Tregtarë aktivë" janë tregtarët të cilët, nëpërmjet vendit të tyre të shitjes gjatë vitit kalendarik për të cilin raportohet, kanë realizuar të paktën një transaksion pagese.
 - "ATM me funksion të transferimit kreditor" (ang.: ATM with a credit transfer function) paraqet ATM (bankomati) që u mundëson përdoruesve të autorizuar të kryejnë transferim kreditor me përdorimin e instrumentit të pagesave të bazuar në kartelë ose mjet tjetër.
 - "ATM me funksion të depozitimit të parave të gatshme" paraqet ATM (bankomati) që u mundëson përdoruesve të autorizuar të depozitojnë para të gatshme në llogarinë e tyre, me përdorimin e instrumentit të pagesave të bazuar në kartelë ose mjet tjetër.
 - "ATM me funksion të tërheqjes së parave të gatshme" (ang.: ATM with a cash withdrawal function) paraqet ATM (bankomati) që u mundëson përdoruesve të

autorizuar të tërheqin para të gatshme nga llogaria e tyre, me përdorimin e instrumentit të pagesave të bazuar në kartelë ose mjet tjetër.

- "Pagesë pa kontakt" (ang.: Contactless payment) paraqet transaksion të pagesave që bëhet me kartelë ose mjet tjetër me ç'rast paguesi dhe tregtari (dhe/ose pajisja e tyre) gjenden fizikisht në vend të njëjtë dhe komunikimit përmes pajisjes portative dhe vendit të shitjes (POS) realizohet nëpërmjet teknologjisë pa kontakt.
- "Numri i klientëve" (ang.: Number of clients) paraqet numrin e përdoruesve të shërbimeve të pagesave të cilëve ju ofrohen shërbime nga ana e ofruesve të shërbimeve për dhënie të informacioneve të llogarive ose ofruesve të shërbimeve për inicim të pagesave.
- "Numri i llogarive të pagesave deri te të cilët kanë aksesuar ofruesit e shërbimeve të pagesave për dhënie të informacione të llogarisë së pagesave" (ang.: Number of accounts accessed by AISPs) paraqet numrin e llogarive të ndryshme deri te të cilët kanë aksesuar ofruesit e shërbimeve për dhënien e informacioneve në periudhën e raportimit.
- "Numri i tregtarëve" paraqet numrin e tregtarëve të cilët pranojnë kartela në pajisjet terminale të vendeve fizike të shitjes dhe numri i tregtarëve të cilët pranojnë pagesa në vendet e shitjes të e-tregtisë. Raportuesit duhet të dorëzojnë të dhëna për numrin e amzës së tregtarëve në bazë vjetore.
- "Numri total i kartelave (pavarësisht nga numri i funksioneve të kartelës)" (ang.: Total number of cards (irrespective of the number of functions on the card)) paraqet numrin total të kartelave në qarkullim. Kartelat mund të kenë një ose më shumë nga funksionet vijuese: funksion të parave të gatshme, funksion debitor, funksion kreditor, funksion të debitimit të shtyrë të llogarisë dhe funksion të parave elektronike.
- "Numri total i transaksioneve të pagesave të cilat përfshijnë jo-MFI" (ang.: Total payment transactions involving non-MFIs) paraqet numrin total dhe vlerën totale të transaksioneve të pagesave me përdorim të instrumenteve të pagesave të cilat përfshijnë jo-MFI.
- "Totali i transaksioneve të dërguara" (ang.: Total transaction sent) paraqet numrin total dhe vlerën e transaksioneve të cilat janë parashtruar dhe përpunuar në një sistem të caktuar të pagesave.
- "Depozitim i parave të gatshme në ATM (me përjashtim të transaksioneve me para elektronike)" (ang.: ATM cash deposit (except e-money transactions)) paraqet depozitim të parave të gatshme që bëhet në ATM (bankomat) me instrument të pagesave të bazuar në kartela ose me mjete të tjera, përfshirë edhe transaksionet nëpërmjet të cilave paratë e gatshme depozitohen në pajisjen terminale, pa ndërhyrje

manuale, me ç'rast paguesi identifikohet me instrumentin e pagesave të bazuar në kartelë, ose me mjete të tjera.

- "Depozitim të parave të gatshme në sportelet e ofruesit të shërbimeve të pagesave" (ang.: Over the counter (OTC) cash deposits) paraqet depozitim të parave të gatshme në llogari të ofruesit të shërbimeve të pagesave (më tutje në tekst: OShP) përmes urdhërësës, si edhe në rastet kur kartela përdoret për identifikim të paguesit.
- "Para të gatshme" (ang.: Cash) janë kartëmonedhat dhe monedhat që mbahen jashtë nga sektori i MFI-së ose në thesaret e MFI-së.
- "Kartelë debitore" (ang.: Debit card) paraqet kategori të instrumentit të pagesave që i mundëson paguesit të iniciojë transaksion me kartelë debitore, duke i përjashtuar transaksionet me kartela të pagesave me parapagesë.
- "Pjesëmarrës direkt" (ang.: Direct participant) paraqet personin i cili është caktuar/pranuar nga sistemi i pagesave dhe është i autorizuar për dërgesë/pranim të urdhërësave të transmetimit direkt në/nga sistemi pa ndërmjetësues ose është direkt i lidhur me rregullat që e rregullojnë sistemin e pagesave. Gjithashtu, në disa sisteme pjesëmarrësit direkt shkëmbejnë urdhëresa për transmetim në emër të pjesëmarrësve indirekt. Çdo pjesëmarrës që ka qasje individuale deri te sistemi numërohet veçmas.
- "Debitim direkt i iniciuar në bazë të një pagese" (ang.: Direct debit initiated on a single payment basis) paraqet debitim direkt të iniciuar në mënyrë elektronike, që është i veçant ndaj debitimeve të tjera direkte d.m.th. të cilat nuk janë pjesë e debitimeve direkte, të iniciuara bashkërisht.
- "Debitim direkt i iniciuar në skedar/grup" (ang.: Direct debit initiated in a file/batch) paraqet debitim direkt të iniciuar në mënyrë elektronike, e cila është pjesë e grupës së debitimeve direkte, të iniciuara bashkërisht nga paguesi. Kur raportohet për numrin e transaksioneve, çdo debitim direkt i cili përfshihet në skedarin numërohet si debitim i veçant direkt.
- "Struktura e diferencuar" (ang.: Tiering arrangement) paraqet strukturën gjatë së cilës pjesëmarrësve indirekt në sistemin e dhënë ju nevojiten shërbimet e pjesëmarrësve direkt që t'i realizojnë transaksionet e tyre.
- "Pjesëmarrësit e tjerë direkt" (ang.: Other direct participants) paraqet çdo pjesëmarrës direkt në sistemin e pagesave, me përjashtim të bankave, të kursimoreve dhe të Bankës Popullore.
- "Shërbime të tjera të pagesave" (ang.: Other payment services) janë shërbime të pagesave të cilat ekzistojnë në shtet, por të cilat nuk mund të përfshihen në kategoritë e shërbimeve të pagesave nga neni 8 i Ligjit të shërbimeve të pagesave dhe sistemeve të pagesave.
- "Shërbime të tjera jo të përfshira me Ligjin e Shërbimeve të Pagesave dhe të Sistemeve të Pagesave" (ang.: Other services) janë shërbime të cilat nuk janë të përfshira me Ligjin e Shërbimeve të Pagesave dhe të Sistemeve të Pagesave dhe nuk janë të përfshira sikur shërbime të pagesave në përputhje me ligjin e njëjtë.

- "Institucione tjera financiare" (ang.: Other financial institutions) janë të gjitha institucionet financiare të cilat marrin pjesë në sistemin e pagesave dhe janë nën mbikëqyrje të organeve kompetente, pra Banka Popullore ose organi i mbikëqyrjes prudenciale, por nuk llogariten si banka dhe kursimore.
- "Emetues tjetër i parave elektronike" (ang.: Other e-money issuer) paraqet emetues të parave elektronike të ndryshëm nga "institucionet e parave elektronike, të bankave dhe të kursimoreve". Shih përkufizimin e "emetuesit të parave elektronike.
- "Ofrues të tjerë të shërbimeve të pagesave dhe emetues të parave elektronike" (ang.: Other PSPs and e-money issuers) janë ofruesit e shërbimeve të pagesave me përjashtim të bankave, kursimoreve, emetuesve të parave elektronike, institucioneve të pagesave dhe Bankës Popullore.
- "Tregti elektronike" (ang.: E-commerce) paraqet blerje dhe shitje të mallrave dhe të shërbimeve ndërmjet kompanive, amvisërive, personave fizikë dhe organizatave private përmes operacioneve elektronike, të realizuara nëpërmjet internetit ose nëpërmjet rrjeteve kompjuterike të tjera ndërmjetësuese (onlajn komunikim). Ky term e përfshin porositjen e mallrave dhe të shërbimeve, të cilat janë dërguar pas rrjeteve kompjuterike, por pagesa dhe dorëzimi final i mallrave dhe i shërbimeve mund të realizohet onlajn ose oflajn.
- "Transaksionet e pagesave elektronike të iniciuara nëpërmjet internetit" janë transaksionet e pagesave të iniciuara nga përdoruesi nëpërmjet internet faqes së raportuesit.
- "Debitim të llogarive me regjistrim të thjeshtë" (ang.: Debits from the account by simple book entry) paraqet transaksion të debitimit të iniciuar nga OShP-ja (përfshirë edhe emetuesin e parave elektronike) pa urdhëresë të posaçme të transaksionit të pagesave dhe e realizuar me regjistrim të thjeshtë kontabilistike të llogarisë së përdoruesit të shërbimeve të pagesave, pra përdorim të instrumentit tradicional të pagesave. Ky zë raportohet për:
 - a) përlllogaritjen e interesit të bankës (interesi aktiv);
 - b) pagesën e kompensimeve;
 - c) pagesën e tatimeve të lidhura me mjetet financiare, nëse janë transaksione të veçanta, por nuk janë të autorizuar veçanërisht nga përdoruesi;
 - c) pagesën e kredisë; dhe
 - d) debitimet tjera të llogarisë nëpërmjet regjistrimit të thjeshtë.
 Këto transaksione janë të përjashtuara nga debitimet direkte.
- "Transaksion i dërguar" (ang.: Transaction sent) paraqet transaksion që i përfshin jo-MFI dërguar OShP-së. Informacioni shfaqet në shtetin e raportimit nga ofruesi rezident i shërbimeve të pagesave. Për shërbimet e tjera të ndryshme të pagesave veprohet si më poshtë:
 - a) transferimet kreditore numërohen në anën e paguesit;
 - b) debitimet direkte numërohen në anën e pranuesit;
 - c) çeqet numërohen në anën e pranuesit;
 - c) transaksionet me kartela të pagesave numërohen në anën e paguesit (emetues);

- d) transaksionet e pagesave me para elektronike numërohen ose në anën e paguesit ose në anën e pranuesit, varësisht nga kanali i inicimit. Nëse numërohen në anën e paguesit si transaksione të dërguara, transaksionet duhet të numërohen në anën e pranuesit si transaksione të pranuar dhe anasjelltas;
- dh) transaksionet me remitanca të pagesave numërohen në anën e paguesit.
- "Transaksione të pagesave mashtruese të cilat përfshijnë jo-MFI" janë:
 - a) transaksionet e pagesave të paautorizuara, përfshirë edhe ato që vijnë nga humbja, vjedhja ose keqpërdorimi i të dhënave të ndjeshme të pagesës ose instrumentit të pagesave, pa dallim nëse paguesi mund t'i zbulojë para pagesës apo jo dhe a është shkaktuar nga një pakujdesi e madhe nga paguesi ose është realizuar pa pajtueshmëri të paguesit ("transaksione të pagesave të paautorizuara"); dhe
 - b) transaksionet e pagesave të cilat janë realizuar si rezultat i manipulimit me paguesin nga ana e mashtruesit të iniciojë urdhërpagesë ose ti jep instruksion OShP-së ta bëjë atë, me vullnet të mirë, drejt llogarisë së pagesave për të cilën besohet se i takon pranuesit legjitim ("manipulim i bërë nga paguesi").
 - "Instant pagesë" (ang.: Instant payment) paraqet pagesë elektronike me pakicë, e cila procedohet në kohë reale 24/7/365 dhe gjatë së cilës mjetet monetare menjëherë i vihen në dispozicion pranuesit.
 - "Institucione të cilat ofrojnë shërbime të pagesave për jo-MFI" (ang.: Institutions offering payment services to non-MFIs) janë të gjitha OShP-të në shtet të cilat mundësojnë shërbime të pagesave të jo-MFI-së.
 - "Inicim të transaksionit të pagesave" (ang.: Initiation of a payment transaction) është dorëzim i urdhërpagesës nga përdoruesi i shërbimit të pagesave.
 - "Pjesëmarrës indirekt" (ang.: Indirect participant) paraqet pjesëmarrësin në sistemin e pagesave me strukturë të diferencuar, i cili e përdor pjesëmarrësin direkt si ndërmjetësues për plotësimin e disa veprimtarive, më saktë shlyerjen e mundësuar në sistem.
Shlyerja e të gjitha transaksioneve të pjesëmarrësit indirekt realizohet në llogarinë e pjesëmarrësit direkt, i cili ka rënë dakord ta konkretisht ta paraqet pjesëmarrësin indirekt. Çdo pjesëmarrës, i cili mund të adresohet individualisht në sistem, numërohet veçmas, pavarësisht nëse ekziston lidhje ligjore mes dy ose më shumë pjesëmarrësve të tillë.
 - "Kartelë" (ang.: Card) paraqet instrument të pagesave të bazuar në një numër unik, i cili mund të përdoret për inicim të pagesës, të tërheqjes ose të depozitimit të parave të gatshme, e cila procedohet me përdorimin e skemës së kartelës së pagesave ose në kuadër të rrjetit të mbështetur nga OShP-ja e cila e ka emetuar kartelën. Numri mund të ruhet në kartelën fizike, në pajisje tjetër (përfshirë edhe varëse çelësash, ngjitëse, telefon të mençur (ang. key tag, sticker, smartphone)) ose virtualisht pa pajisje fizike. Në përputhje me marrëveshjen me ofruesin e shërbimit të pagesave i cili e ka emetuar kartelën, kartelat i ofrojnë mbajtësit të kartelës një ose më shumë nga këto funksione: para të gatshme, debitor, debitim të shtyrë, kreditor dhe para elektronike.

- "Kartelë me funksion të pagesës pa kontakt" (ang.: Card with a contactless payment function) është kartelë e cila përdoret për inicim të transaksionit të pagesave me lloj të posaçëm të teknologjisë pa kontakt dhe me kusht paguesi dhe pranuesi (dhe/ose pajisja e tyre) të gjinden fizikisht në vend të njëjtë.
- "Kartelë me funksion të parave të gatshme" (ang.: Card with a cash function) është kartela e cila i mundëson mbajtësit të tërheq para të gatshme nga ATM-i dhe/ose të depozitojë para të gatshme në ATM.
- "Kartelë me funksion të kombinuar, debitor, të parave të gatshme dhe të parave elektronike" (ang.: Card with a combined debit, cash and e-money function) është kartela e emetuar nga OShP-ja, e cila ka funksion të kombinuar të parave të gatshme, debitor dhe të parave elektronike.
- "Kartelë e cila mundëson qasje deri te paratë elektronike të cilat ruhen në llogarinë e parave elektronike" (ang.: Card which give access to e-money stored on e-money accounts) është kartela e përshkruar në përkufizimin e "llogarisë së parave elektronike".
- "Kartelë në të cilën mund direkt të ruhen paratë elektronike" (ang.: Card on which e-money can be stored directly) janë para elektronike, të cilat ruhen në kartelën e cila është në pronësi të mbajtësit të parave elektronike. Shih përkufizimin e "parave elektronike".
- "Kartelë me debitim të shtyrë" (ang.: Delayed debit card është kartelë e cila i mundëson mbajtësit që blerjet e tij të regjistrohen në llogari të OShP-së, e cila emeton kartelat deri në limitin e miratuar. Gjendja e asaj llogarie, pastaj, në tërësi paguhet në fund të periudhës së përcaktuar kohore. Mbajtësit zakonisht i paguhet tarifë vjetore. Karakteristikë e rëndësishme e kartelës me debitim të shtyrë, krahasuar me kartelën me funksion debitor ose funksion kreditor, është dispozita në bazë të cilës mbajtësit të kartelës i miratohet linjë kreditore, me detyrim që borxhin ta shlyejë deri në fund të afatit të përcaktuar paraprakisht pa pagesë të interesit. Ky lloj i kartelës zakonisht emërohet "kartelë me tarifim të shtyrë" (ang.: "charge – card")
- "Kartelë kreditore" (ang.: Credit card) është kategori e instrumentit të pagesave i cili i mundëson paguesit të iniciojë transaksion me kartelë kreditore.
- "Kartelë me funksion të pagesës (me përjashtim të kartelave vetëm me funksion të parave elektronike)" (ang.: Card with a payment function except cards with an e-money function only) është kartela me vetëm një prej këtyre funksioneve: funksion debitor, me debitim të shtyrë ose kreditor. Kartela mund të ketë edhe funksione tjera, siç është funksioni i parave elektronike, por nëse kartela ka vetëm funksion të parave elektronike, nuk përfshihet në këtë kategori. Nuk përfshihen kartelat vetëm me funksion të parave të gatshme.
- "Kartelë me funksion të parave elektronike." (ang.: Card with an e-money function) është kartela në të cilën mund të ruhen para elektronike direkt dhe/ose e cila jep qasje kartelës deri te paratë elektronike të ruajtura në llogarinë e parave elektronike, e cila mundëson realizimin e transaksioneve të pagesave me para elektronike.

- "Kartelë me funksion të parave elektronike e cila është mbushur të paktën një herë" (ang.: Card with an e-money function which has been loaded at least once) është kartelë e cila është mbushur të paktën një herë dhe me atë llogaritet si aktive. Mbushja mund të interpretohet si tregues i qëllimit të përdorimit të funksionit të parave elektronike.
- "Transfer kreditor i iniciuar në formë letre" (ang.: Credit transfer initiated in paper-based form) është transferimi kreditor i iniciuar nga paguesi në formë letre, ose nëpërmjet instruksionit të shprehur gojarisht deri te zyrtari i punësuar te OShP-ja me qëllim të inicimit të transferimit kreditor ose ndonjë transferimi tjetër kreditor, për të cilin nevojitet intervenim manual.
- "Transferime kreditore të iniciuara në mënyrë elektronike" (ang.: Credit transfers initiated electronically) janë transferimet kreditore të cilat paguesi i dorëzon pa përdorimin e formës së letrës, d.m.th. i dorëzon në mënyrë elektronike.
- "Transferim kreditor i bazuar në onlajn bankim" (ang.: Online banking based credit transfers) paraqet transferim kreditor të iniciuar me onlajn bankim dhe shërbime për inicim të pagesës.
- "Transferimi kreditor i iniciuar në bazë të një pagese" (ang.: Credit transfer initiated on a single payment basis) paraqet transferim kreditor i iniciuar në mënyrë elektronike, i cili është i pavarur nga transferimet tjera kreditore, pra nuk paraqet pjesë nga grupi i transferimeve kreditore, të iniciuara bashkërisht.
- "Transfer kreditor i iniciuar në skedar/grupe" (ang.: Credit transfer initiated in a file/batch) paraqet transferim kreditor të iniciuar në mënyrë elektronike, i cili është pjesë nga grupi i transferimeve kreditore të iniciuar bashkërisht nga ana e paguesit nëpërmjet linjës së dedikuar. Çdo transferim kreditor i përfshirë në grupin numërohet si transferim i veçantë kreditor kur raportohet për numrin e transaksioneve.
- "Transferime kreditore të iniciuara nga MFI-të ndaj MFI-ve të tjera" janë transferime kreditore të iniciuara nga banka, kursimorja ose nga Banka Popullore, e cila raporton drejt MFI-së tjetër.
- "Kod i kategorisë së tregtarit" (ang.: Merchant category code (MCC)) paraqet kod katërshifror (specifikuar në standardin ISO 18245) për shërbime financiare me pakicë. Përdoret për klasifikim të tregtarit sipas llojit të mallrave dhe të shërbimeve që i dorëzojnë.
- "Pika e shitjes" (ang.: Point of sale) është adresa fizike e hapësirës afariste në të cilën tregtari e inicion transaksionin. Por:
 - a) nëse shitja është e largët ose është kryer marrëveshja nëpërmjet mjeteve të komunikimit të largësisë (d.m.th E-tregti), pika e shitjes është adresa e udhëheqësisë në të cilën tregtari e realizon veprimtarinë e tij pavarësisht nga vend se ku ndodhet internet faqja, pra ofruesi i shërbimeve të pagesave nëpërmjet të cilit është iniciuar transaksioni i pagesave;

- b) nëse tregtari nuk ka udhëheqësi, pika e shitjes e adresës së selisë, për të cilën tregtari ka leje të vlefshme të veprimtarisë dhe nëpërmjet së cilës transaksioni i pagesave nëpërmjet mjeteve të komunikimit nga largësia është iniciuar;
 - c) nëse tregtari nuk ka seli dhe as leje të vlefshme, pika e shitjes është adresa e cila përdoret për korrespondencë në lidhje me pagesën e tatimeve të cilat kenë të bëjnë me aktivitetin e tij të shitjes dhe nëpërmjet së cilës transaksioni i pagesave nëpërmjet mjeteve të komunikimit është iniciuar.
- „Vendet e shitjes për e-tregti” janë vende të cilat mundësojnë blerje të mallrave dhe të shërbimeve në shtet nëpërmjet internetit ose nëpërmjet rrjeteve tjera ndërmjetësuese (onlajn komunikim). Shih përkufizimin e “tregtisë elektronike”.
- “Institucione monetare financiare (MFI)” (ang.:) janë Banka Popullore, bankat dhe kursimoret në përputhje me Ligjin e Bankave dhe fondeve të tregjeve të parave.
- “Institucione financiare jomonetare (jo-MFI)” (ang.: Non-MFI) paraqet çdo person fizik dhe juridik i cili nuk është pjesë e sektorit MFI. Për qëllimet e statistikës së pagesave, OShP-të janë përjashtuar nga sektori jo-MFI.
- “Miratim të llogarive me regjistrim të thjeshtë” (ang.:) paraqet transaksion për miratim e iniciuar nga ofrues i shërbimeve të pagesave (përfshirë edhe emetuesin e parave elektronike) pa urdhëresë të posaçme të transaksionit të pagesave dhe e realizuar me regjistrim të thjeshtë kontabilist (regjistrim i thjeshtë kontabilist i llogarisë së përdoruesit të shërbimeve të pagesave, pa përdorim të instrumentit tradicional të pagesave). Në këto dy pozita raportohen:
 - a) pagesë interesi nga banka;
 - b) pagesë të dividendit nga banka;
 - c) shlyerje të kredisë në llogarinë e pagesave të klientit; dhe
 - ç) kredi tjera në llogari nëpërmjet regjistrimit të thjeshtë.
 Këto të dhëna përjashtohen nga kategoria e transferimeve kreditore.
- “Organe të qeverisë shtetërore” janë përdoruesit dhe njësitë e përdoruesve të mjeteve të Buxhetit të Republikën e Maqedonisë së Veriut, agjencitë dhe institucionet publike dhe organizatat tjera të bazuara në shtet, me mjetet e të cilave disponon Republika e Maqedonisë së Veriut.
- “Transaksione të pagesave të bazuara në kartela, me instrumente të pagesave të bazuara në kartela të emetuara nga rezidentë OShP, të iniciuara në mënyrë elektronike” (ang.: Card-based payment transaction with card-based payment instruments issued by resident PSP initiated electronically) janë transaksionet e pagesave, të bazuara në kartela, të cilat janë të iniciuara në pajisje terminale EFTPOS, ATM ose tjetër pajisje terminale në vendet fizike të shitjes, i cili mundëson inicim të pagesës elektronike, ose me mjete elektronike të dhënies së informacioneve nga distanca. Transaksionet e pagesave të bazuara në kartela, të emetuara nga rezidentë OShP, të iniciuara në formë letre (p.sh. Imprinter për instrumente të pagesave të bazuara në kartela, ose nëse informacioni i pagesave mbledhet manualisht në kuponët e letrës), nuk përfshihen.
- “Transaksione të pagesave të bazuara në kartela me instrumente të pagesave të bazuara në kartela të emetuara nga rezidentë OShP, të cilat nuk janë iniciuar në mënyrë elektronike” (ang.: Card-based payment transaction with card-based payment

instruments issued by resident PSP initiated non-electronically) janë transaksionet e pagesave të bazuara në kartela, të cilat janë të iniciuara në pajisjen terminale në vendet fizike të shitjes, nëpërmjet procedurës manuale të autorizimit (p.sh. Imprinterë) (transaksione me paraqitje fizike të kartelës) ose me urdhër me anë të postës ose telefonatës (transaksione pa paraqitje fizike të kartelës).

- "Transaksione të pagesave të bazuara në kartela me instrumente të pagesave të bazuara në kartela të emetuara nga rezidentë OShP (me përjashtim të kartelave me funksion vetëm për para elektronike)" (ang.: Card-based payment transaction with card-based payment instruments issued by resident PSP (except cards with an e-money function only) janë transaksionet e pagesave të bazuara në kartela, të realizuara me kartela debitore, kartela me debitim të shtyrë ose me kartela kreditore në pajisje terminale ose nëpërmjet kanaleve tjera.

Në këtë kategori përfshihen të gjitha transaksionet e pagesave të iniciuara me instrument të pagesave, të bazuar në kartela, d.m.th.:

- a) të gjitha transaksionet, gjatë së cilave OShP-ja pranon instrument pagesave/transaksion të pagesave të bazuar në kartelë dhe OShP-ja e cila emeton instrument të pagesave të bazuar në kartelë janë persona të ndryshëm;
- b) të gjitha transaksionet, gjatë së cilave OShP-ja pranon instrument të pagesave/transaksion të pagesave të bazuar në kartelë dhe OShP-ja e cila emeton instrument të pagesave të bazuar në kartelë janë person i njëjtë;

Përfshihen të gjitha tërheqjet nga llogaria e OShP-së të cilat dalin nga shlyerja e transaksionit të pagesave të bazuar në kartela të OShP-ja e cila pranon edhe OShP e cila emeton instrument të pagesave të bazuar në kartela janë subjekt i njëjtë.

Përfshihen transaksionet e pagesave të bazuara në kartela të realizuara me anë të telefonit ose përmes internetit me përdorimin e instrumentit të pagesave të bazuar në kartelë.

Nuk përfshihen transaksionet e pagesave me para elektronike.

Nuk përfshihen tërheqja dhe depozitimi i parave të gatshme në ATM. Ato raportohen si "Transaksione në ATM me funksion të tërheqjes së parave të gatshme" dhe "Transaksione në ATM me funksion të depozitimit të parave të gatshme".

Nuk përfshihen transferimet kreditore në ATM. Ato raportohen si "transferime kreditore".

Nuk përfshihet tërheqja e parave të gatshme në pajisjet terminale POS.

- "Transaksioni i pagesave i bazuar në kartelë, i iniciuar në pajisjet terminale EFTPOS" (ang.: Card-based payment transaction initiated at a physical EFTPOS) paraqet transaksion të pagesave të bazuar në kartelë, i iniciuar në mënyrë elektronike në pajisjet terminale POS, në të cilin mund të bëhen transferime elektronike të mjeteve. Kjo normë zakonisht përfshin transaksione të pagesave të bazuara në kartelë, nëpërmjet transferimeve elektronike të mjeteve në pajisjet terminale (EFTPOS) në objektin e tregtarit. Nuk përfshihen transaksionet e pagesave me para elektronike.
- "Transaksione të pagesave të bazuara në kartela me debitim të shtyrë" janë transaksionet e pagesave me instrumente të pagesave të bazuara në kartela me debitim të shtyrë në pajisjet terminale në vendet fizike të shitjes ose përmes kanaleve tjera.

- "Transaksione të pagesave me para elektronike" (ang.: E-money payment transaction) paraqet transaksion të pagesave me përdorim të parave elektronike. Shih përkufizimin e "parave elektronike".
- "Transaksione të pagesave me para elektronike nga të cilat: të disponueshme nëpërmjet kartelës" (ang.: E-money payment with e-money accounts of which: accessed through a card) paraqet transaksion gjatë së cilit kartela përdoret për qasje te llogaria dhe pastaj, për transferim të mjeteve nga llogaria e parave elektronike e paguesit në llogarinë e pranuesit. Shih përkufizimin për "llogari të parave elektronike".
- "Llogari të pagesave me qasje për kontrollim përmes internetit dhe/ose zgjidhje për pagesë me celular" janë llogaritë e hapura të pagesave të cilat personave fizikë dhe juridikë ju mundësojnë qasje për kontrollim të gjendjes, ndryshimeve dhe pasqyrën e llogarisë së pagesave, jashtë hapësirave të OShP-së, duke përdorur internet ose zgjidhje për pagesë me celular. Kontrollimi në llogaritë e pagesave realizohet me përdorimin e kompjuterit, celularit ose ndonjë pajisjes tjetër të mençur, ATM, faks ose makinë zëri të cilët ofrojnë diapazon të gjerë të njoftimit për gjendjen dhe ndryshimet e llogarive të përdoruesit të shërbimeve të pagesave nëpërmjet hyrjes në internet faqet e OShP-së, dërgesës së SMS-it, e-mail etj.
- "Llogari e pagesave me qasje për inicim të transaksioneve të pagesave nëpërmjet internetit dhe/ose zgjidhje për pagesë me celular" janë llogaritë e hapura të pagesave të cilat personave fizikë dhe juridikë ju mundësojnë të bëjnë transaksione të pagesave elektronike dhe njëkohësisht qasje për kontrollim të gjendjes, ndryshimeve dhe pasqyrën e llogarisë së pagesave, jashtë hapësirave të OShP-së, duke përdorur internet ose zgjidhje për pagesë me celular. Inicimi i llogarive të pagesave realizohet me përdorimin e kompjuterit, celularit ose ndonjë pajisjes tjetër të mençur, ATM, faks ose makinë zëri të cilët ofrojnë diapazon të gjerë të njoftimit për gjendjen dhe ndryshimet e llogarive të përdoruesit të shërbimeve të pagesave nëpërmjet hyrjes në internet faqet e OShP-së, dërgesës së SMS-it, e-mail etj.
- "Transaksione të pagesave me para elektronike me kartela me para elektronike" i përfshin kartelat me funksion të parave elektronike në të cilat direkt mund të ruhen paratë elektronike dhe kartela të cilat mundësojnë qasje deri te paratë elektronike të cilat ruhen në llogarinë e parave elektronike.
- "Pagesë me para elektronike nëpërmjet llogarisë së parave elektronike, nga të cilat: të disponueshme me kartelë" (ang.: E-money payment with e-money accounts of which: accessed through a card) është transaksion gjatë së cilit kartela përdoret për qasje te llogaria e parave elektronike dhe mjetet më pas transferohen nga llogaria e parave elektronike e paguesit në llogarinë e parave elektronike të pranuesit.
- "Tërheqje të parave të gatshme nga pajisjet terminale POS" (ang.: Cash advance at point of sale (POS) transaction) paraqet transaksion gjatë së cilit mbajtësi i kartelës nëpërmjet përdorimit të kartelës ose pajisjeve tjera pranon para të gatshme në pajisjet terminale në vendet fizike të shitjes gjatë kombinimit të kartelës së pagesave për mallra dhe shërbime (i quajtur shpesh "kthim i parave të gatshme" (ang.: „cash-back transactions").

- "Tërheqje e parave të gatshme në ATM (me përjashtim të transaksioneve me para elektronike)" paraqet tërheqje të parave të gatshme në ATM me përdorimin e instrumentit të pagesave të bazuar në kartelë ose pajisje tjera.
- "Tërheqja e parave të gatshme në sportelet e OShP-së" paraqet tërheqje të parave të gatshme nga llogaria e OShP-së nëpërmjet urdhëresës në formë letre, si në rastet kur kartela përdoret për identifikim të pranuesit.
- "Transaksion i përsëritur" (ang.: Recurring transaction) paraqet nënkategori të transaksioneve në vende të shitjes për e-tregti dhe përfshin pagesa me kartela të pagesave për mallra dhe shërbime nëpërmjet internetit në intervale të përcaktuara paraprakisht (anëtarësime, parapagesa dhe të ngjashme).
- "Mbushje dhe zbraze të vlerës së kartelës së parave elektronike" (ang.: E-money card-loading and unloading) janë transaksionet të cilat mundësojnë transferim të vlerës së parave elektronike nga emetuesi i parave elektronike te mbajtësi i kartelës me funksion të parave elektronike dhe anasjelltas, pra mbushjen dhe zbrazen.
- "Transaksion i pranuar" (ang.: Transaction received) paraqet transaksioni që i përfshin jo-MFI-të, e pranuar nga OShP-ja. Informacionin e shfaq OShP rezident, me çka transaksionet me kartela të pagesave numërohen nga ana e pranuesit.
- "Rezidentë" janë personat e definuar në përputhje me Ligjin e operacioneve valutore.
- "Zgjidhje për pagesa celulare" (ang.: Mobile payment solution) është zgjidhja e cila përdoret për inicim të pagesave, me çka të dhënat për pagesa dhe instruksione të pagesave transmetohen dhe/ose vërtetohen përmes komunikimit celular dhe teknologjisë së transferimit të të dhënave përmes pajisjes celulare. Kjo kategori përfshin portofola digjitale dhe zgjidhje të tjera për pagesë celulare të cilat përdoren për inicim të transaksioneve nga personi në person (P2P) dhe/ose nga konsumatori te tregtari (C2B), d.m.th. Transferime kreditore, pagesa me kartela dhe/ose transaksione me para elektronike.
- "P2P zgjidhje për pagesa celulare" (ang.: P2P mobile payment solution) është zgjidhje gjatë së cilës iniciohen pagesat, të konfirmuara dhe/ose pranuar nga personi fizik deri te personi tjetër (P2P) nëpërmjet pajisjes celulare. Instruksion për pagesë dhe të dhëna tjera të pagesës transferohen dhe/ose konfirmohen nëpërmjet pajisjes celulare. Si mjet për përcaktimin e identitetit të pagesës dhe/ose të pranuesit mund të përdoret një identifikues i vetëm për pagesë celulare si për shembull telefon celular ose adresa e postës elektronike. P2P zgjidhjet e pagesave celulare mund të përdoren për inicim të transferimeve kreditore, pagesave me kartela dhe/ose transaksioneve me para elektronike.
- "Llogari e parave elektronike" (ang.: E-money account) është llogaria në të cilën ruhen paratë elektronike, ndërsa mbajtësi i llogarisë mund ta përdor gjendjen e llogarisë së realizimit të transaksioneve të pagesave dhe transferim të mjeteve monetare nëpërmjet llogarive.
- "Llogari e parave elektronike e disponueshme me kartelë" (ang.: E-money account accessed through a card) në përputhje me përkufizimet "llogari të parave elektronike" dhe "kartelë me funksion të parave elektronike".

- "Gjendja e instrumenteve për ruajtje të parave elektronike të emetuara nga emetues të parave elektronike" (ang.: Outstanding value on e - money storages issued by electronic money issuers) është gjendja në fund të periudhës raportuese të parave elektronike të emetuara nga emetues të parave elektronike dhe të ruajtura nga persona tjerë, përfshirë edhe emetuesit e parave elektronike përveç emetuesit.
- "Pajisje terminale ATM" (ang.: Automated teller machine (ATM)) është pajisja elektromekanike e cila ju mundëson përdoruesve të autorizuar të cilët përdorin instrument të pagesave të bazuar në kartelë ose pajisje tjetër, të tërheqin para të gatshme nga llogaritë e tyre dhe/ose të kenë qasje deri te shërbimet tjera, e cila ju mundëson, mes tjera, ta kontrollojnë llogarinë, të transferojnë mjete monetare ose të depozitojnë para të gatshme.
- "Transaksionet në ATM (me përjashtim të transaksioneve me para elektronike)" janë transaksionet e pagesave në ATM me përdorimin e instrumentit të pagesave të bazuar në kartelë ose pajisje tjera. Nuk përfshihen transaksionet e pagesave me para elektronike.
- "Transaksionet në pajisjet terminale në të cilat rezidentë OShP i pranojnë transaksionet me kartela të emetuara nga rezidentë OShP" (ang.: Transactions at terminals at which transactions are acquired by resident PSPs with cards issued by resident PSPs) janë transaksionet e pagesave të realizuara në të gjitha pajisjet terminale, në të cilat transaksionet janë të pranuar nga rezidentë të OShP-së dhe gjatë së cilës kartelat me të cilat janë të realizuara transaksionet janë të emetuara nga rezidentë OShP (pavarësisht nëse pajisjet terminale janë të vendosura në ose jashtë shtetit në të cilën gjinden OShP-të). Shpërndarja gjeografike ka të bëjë me vendndodhjen e pajisjeve terminale.
- "Transaksionet në pajisjet terminale në të cilat rezidentë OShP i pranojnë transaksionet me kartela të emetuara nga rezidentë OShP" (ang.: Transactions at terminals at which transactions are acquired by resident PSPs with cards issued by non-resident PSPs) janë transaksionet e pagesave të realizuara në të gjitha pajisjet terminale, në të cilat transaksionet janë të pranuar nga rezidentë të OShP-së dhe gjatë së cilës kartelat me të cilat janë të realizuara transaksionet janë të emetuara nga jorezidentë OShP (pavarësisht nëse pajisjet terminale janë të vendosura në ose jashtë shtetit në të cilën gjinden OShP-të). Shpërndarja gjeografike ka të bëjë me vendndodhjen e pajisjeve terminale.
- "Transaksionet në pajisjet terminale në të cilat rezidentë OShP i pranojnë transaksionet me kartela të emetuara nga rezidentë OShP" (ang.: Transactions at terminals at which transactions are acquired by non-resident PSPs with cards issued by resident PSPs) janë transaksionet e pagesave të realizuara në të gjitha pajisjet terminale në të cilat transaksionet pranohet nga jorezidentë OShP (pavarësisht nëse pajisjet terminale janë në ose jashtë shtetit në të cilin gjinden OShP-të) dhe gjatë së cilës kartelat e përdorura për transaksionet janë të emetuara nga rezidentë OShP. Vendndodhja gjeografike ka të bëjë me vendndodhjen e pajisjeve terminale.
- "Transaksione në vendet e shitjes së e-tregtisë" (ang.: E-commerce payments) janë nënkategori e transferimeve të kredisë të iniciuara me onlajn banking.

- "Transaksion me para elektronike nëpërmjet kartelës në të cilën direkt mund të ruhen paratë elektronike" (ang.: E-money payment with cards on which e-money can be stored directly) paraqet transaksion në të cilin mbajtësi i kartelës me funksion të parave elektronike transferon mjete monetare nga llogaria e tij për para elektronike në llogarinë e parave elektronike të përdoruesit.
- "Transaksion me përdorim të parave elektronike nëpërmjet llogarive me para elektronike" (ang.: E-money payment with e-money accounts) paraqet transaksion gjatë të cilit mjetet monetare nga llogaria e parave elektronike e pagesit transferohen në llogarinë e parave elektronike të pranuesit.
- "Pajisje terminale për kartela me para elektronike" (ang.: E-money card terminal) është pajisje terminale e cila mundëson transferim të vlerës elektronike nga emetuesi i parave elektronike të mbajtësit të kartelës me funksion të parave elektronike dhe anasjelltas (të ashtuquajtur mbushje dhe zbrazje) ose pajisjes terminale e cila i mundëson mbajtësit të parave elektronike në kartelë me funksion të parave elektronike ta transferojë vlerën e parave elektronike nga gjendje në gjendjen e tregtarit ose ndonjë përdoruesi tjetër.
- "Pajisje terminale për mbushje dhe zbrazje të vlerës së kartelës së parave elektronike" (ang.: E-money card loading and unloading terminal) është pajisje terminale e cila mundëson transferim të vlerës së parave elektronike nga emetuesi i parave elektronike të mbajtësi i kartelës me funksion të parave elektronike dhe anasjelltas, pra mbushjen dhe zbrazjen.
- "Pajisje terminale për kartela me para elektronike" (ang.: E-money card accepting terminal) është pajisje terminale e cila i mundëson mbajtësit të parave elektronike të kartelës me funksion të parave elektronike ta transferojë vlerën e parave elektronike nga gjendja e tij në gjendjen e tregtarit ose një përdoruesi tjetër.
- "Pajisje terminale POS" (ang.: Point of sales (POS) terminal) është pajisje fizike e cila përdoret në vendin e shitjes me pakicë për shkak të mbledhjes së informacionit pageor, zakonisht në mënyrë elektronike, për transaksionet nga blerësi ndaj tregtarit (blerje). Të dhënat për pagesë mirren ose manualisht ose me vaçerë letre, ose nëpërmjet mjeteve elektronike, d.m.th. EFTPOS.
- "Pajisje terminale EFTPOS" (ang.: EFTPOS terminal) është pajisje terminale për transferim elektronik të mjeteve të shitjes i cili e pranon informacionin e pagesave nëpërmjet mjeteve elektronike dhe është i bërë, që në disa raste, ta transferojë atë informacion onlajn, me kërkesë për autorizim në kohë reale, ose oflajn. Pajisjet terminale EFTPOS i përfshijnë pajisjet terminale për vetëkryerje të pagesave.
- "Pajisje terminale POS për pranim të transaksioneve me para elektronike" (ang.: POS terminal accepting e-money transactions) është pajisje terminale POS, e cila gjithashtu mund të pranojë pagesa me para elektronike. Nuk përfshihen pajisjet terminale për kartela me para elektronike të cilat mund t'i pranojnë vetëm pagesat me para elektronike. Shih përkufizimin për "pajisje terminale për kartela me para elektronike".
- transferime kreditore për shlyerjen e kështit/anuitetit të kredisë të iniciuara nëpërmjet internetit ose zgjidhjes për pagesë celulare e ngarkuar në llogarinë e pagesave të

përdoruesit të shërbimeve të pagesave, në dobi të "llogarisë së pagesave" tjetër të OShP-së.

69. Transferimet kreditore e iniciuara elektronikisht, më tutje ndahen në: "të iniciuara nëpërmjet skedarit/grupit" dhe "të iniciuara në bazë të një pagese". Numri total i transferimeve kreditore të iniciuara në mënyrë elektronike paraqesin shumën e këtyre nënkategorive. I njëjti parim vlen edhe te vlera totale e transferimeve kreditore të iniciuara në mënyrë elektronike.
70. Transferimet kreditore të iniciuara në mënyrë elektronike, në bazë të një pagese, nga aspekti i zgjidhjes teknologjike, siç janë iniciuar, ato ndahen në: transferimet kreditore të bazuara në onlajn banking, ATM ose tjetër pajisje terminale të OShP-ve dhe zgjidhje të pagesave celulare. Transferimet kreditore të bazuara në onlajn banking përfshihen në nënkategorinë: "pagesa gjatë tregtisë elektronike", ndërsa transferimet kreditore të iniciuara nëpërmjet zgjidhjes së pagesave celulare, përfshihen në kategorinë "P2P zgjidhje të pagesave celulare".
71. Nëse urdhërpagesa iniciohet në një pajisje elektronike, ndërsa nënshkrimi/autorizimi bëhet në tjetër pajisje elektronike, atëherë për qëllimet e raportimit, për pajisje në të cilin është iniciuar transaksioni llogaritet ai në të cilin është nënshkruar/autorizuar urdhëresa.
72. Transferimet kreditore të iniciuara në bazë të vendimit për pagesë të detyruar ose nëpërmjet urdhëresës së përhershme të cilat janë iniciuar në formë letre ose elektronike, shfaqen në artikujt e veçantë "të iniciuar në bazë të vendimit për pagesë të detyruar" dhe "të iniciuara nëpërmjet urdhëresës së përhershme", me ç'rast përfshihen edhe në kornizat e kategorisë "Transferime kreditore të iniciuara nga jo-MFI-të", në formë letre dhe elektronike, përkatësisht.
73. Transferimet kreditore të iniciuara nëpërmjet ofruesve të shërbimeve të inicimit të pagesave, numërohen në kuadër të kategorisë "Transferim kreditor i bazuar në onlajn banking, pagesa mbi tregtinë elektronike", por edhe veçmas në kategorinë: "Shërbime për inicim të pagesave".
74. Transaksionet të cilat përfshijnë para të gatshme në njërën ose dyja anët e transaksionit të pagesave dhe te të cilat përdoret shërbimi i pagesave transferim kreditor, përfshihen në transferimet kreditore.

Debitime direkte

75. Në këtë kategori përfshihen debitimet direkte "të iniciuara në bazë të një pagese" dhe debitimet direkte "të iniciuara në skedar/grup". Në rast të debitimeve direkte të cilat janë iniciuar në skedar/grup, çdo pagesë individuale numërohet si një transaksion. Numri total i debitimeve direkte të iniciuara paraqet shumën e këtyre nënkategorive. I njëjti parim vlen edhe te vlera totale e debitimeve direkte.
76. Debitimet direkte të cilat përdoren për shlyerjen e detyrimeve të cilat dalin nga përdorimi i kartelave kreditore, të kartelave debitore ose kartelave me debitim të shtyrë, gjithashtu, përfshihen këtu, sepse janë pagesa të veçanta nga mbajtësi i kartelës ndaj OShP-së i cili e emeton kartelën. Të dhënat e debitimeve direkte të cilat

dalën nga çdo transaksion individual me kartelë nuk duhet të dorëzohen që të shmanget numërimi i dyfishtë.

77. Transaksionet me debitim direkt janë të ndara në "pëlqim i dhënë nëpërmjet mandatit elektronik" dhe "pëlqim i dhënë në formë tjetër". Nënkatëgoritë përjashtohen mese vete. Totali i tyre është i njëjtë me numrin total të debitimeve direkte. I njëjti parim vlen edhe te vlera totale e debitimeve direkte.
78. Pagesat me para të gatshme nga llogaria me përdorim të urdhërësës së posaçme, nuk përfshihen në debitimet direkte.

Transaksione të pagesave të bazuara në kartelë

79. Transaksionet e pagesave të bazuara në kartelë me instrumente të pagesave të bazuara në kartelë të emetuara nga rezidentë OShP, paraqiten nga OShP-ja, e cila emeton kartelë pavarësisht nga lokacioni i brendit të pagesave nëpërmjet së cilit realizohet transaksioni, pra pavarësisht se ku është realizuar transaksioni, në shtet apo jashtë shtetit.
80. Këtu përfshihen edhe të dhënat e transaksioneve me instrumente të pagesave të bazuara në kartela në vendet virtuale të shitjes nëpërmjet internetit ose telefonit.
81. Transaksionet e pagesave të bazuara në kartelë me instrumente të pagesave të bazuara në kartelë, gjithashtu ndahen në: "të iniciuara në mënyrë elektronike" dhe "të iniciuara jo në mënyrë elektronike". Meqenëse kanalet e inicimit reciprokisht përjashtohen, numri total i transaksioneve të pagesave të bazuara në kartelë paraqesin totalin e kanaleve të inicimit. I njëjti parim vlen edhe për transaksionet me vlerë totale.
82. Transaksionet e pagesave me instrumente të pagesave të bazuara në kartela, të iniciuara në mënyrë elektronike më tej ndahen në: "të iniciuara nëpërmjet zgjidhjes së pagesave celulare", të iniciuara në pajisjen terminale fizike EFTPOS", të iniciuara në vendet e shitjes për e-tregti", "të iniciuara në ATM" dhe "tjera". Numri total i pagesave me instrumente të pagesave të bazuara në kartela paraqet totalin e nënkategorive të caktuara. I njëjti parim vlen edhe te vlera totale e pagesave me instrumente të pagesave të bazuara në kartela.
83. Nënkatëgoria "transaksione të përsëritura" në kuadër të kategorisë "të iniciuara në vendet e shitjes për e-tregti" përfshin pagesa me instrumente të pagesave të bazuara në kartela të pagesave për mallra dhe shërbime nëpërmjet internetit në intervale të përcaktuara paraprakisht (anëtarësime, parapagesa dhe të ngjashme).
84. Transaksionet e pagesave me instrumente të pagesave të bazuara në kartela raportohen edhe nga aspekti se a është kartela debitore, kreditore ose me funksion debitor të shtyrë. Çdo transaksion numërohet në nënkategorinë përkatëse. Numri total i pagesave me instrumente të pagesave me kartela paraqet totalin e këtyre nënkategorive. I njëjti parim vlen edhe te vlera totale e pagesave me kartela. Këtu nuk përfshihen pagesat me instrumentet të pagesave të bazuara në kartela të emetuara në shtet të cilat kanë vetëm funksion të parave elektronike.

Tërheqja e parave të gatshme me ndihmën e instrumenteve të pagesave të bazuara në kartelë (përveç transaksioneve me para elektronike)

85. Tërheqjet e parave të gatshme me instrumente të pagesave të bazuara në kartela të emetuara nga rezidentë OShP, (përveç transaksioneve me para elektronike" dhe të paraqitur nga OShP e cila emeton kartelë të pagesave janë të përfshirë në këtë kategori.
86. Numri i tërheqjeve duhet të paraqitet për çdo funksion të kartelës (d.m.th. kartelë debitore, kartelë me funksion të debitimit të shtyrë dhe kartelë kreditore). I njëjti parim vlen edhe për vlerën e transaksioneve.

Transaksione të pagesave me para elektronike

87. Çdo transaksion numërohet në nënkategorinë e veçantë "me kartelë në të cilën mundet direkt të ruhen paratë elektronike" ose "me llogari të parave elektronike". Numri total i transaksioneve me para elektronike paraqet totalin e këtyre nënkategorive. I njëjti parim vlen edhe te vlera totale e transaksioneve me para elektronike.
88. Transaksionet "me llogari të parave elektronike" më tej ndahen që të japin informacion për atë se sa nga ato mundësojnë qasje nëpërmjet kartelës, zgjidhje të pagesave celulare dhe tjera.
89. "P2P zgjidhje për pagesë celulare" është nënkategoria me "zgjidhje për pagesa celulare".

Çeqe

90. Përfshihet tërheqja e parave të gatshme me përdorim të çeqeve.
91. Shfaqen të dhëna për çeqet të cilat janë dorëzuar për pagesë nga mbajtësi dhe të ngarkuara në llogaritë e pagesave të bankës dhe të cilat banka i ka pranuar nëpërmjet rrjetit të saj afarist ose nëpërmjet palës së tretë (institucion i cili në bazë të kontratës i realizon pagesat në emër dhe llogari të bankës). Të dhënat i paraqet raportuesi përgjegjës.

Dërgesat në para

92. Raportohen të dhënat e shërbimit të pagesave - dërgesat në para në denarë. Pranimi i mjeteve monetare nga paguesi, me qëllim të shumës përkatëse të mjeteve monetare të transferohet të pranuesi ose OShP tjetër i cili vepron në emër dhe llogari të pranuesit dhe/ose ku mjetet monetare pranohen në emër dhe llogari të pranuesit dhe i vihen në dispozicion, pa hapur llogari të pagesave në emër të paguesit ose pranuesit, raportohet në kategorinë "dërgesat në para".
93. Dërgesat në para raportohen nga ana e OShP-së e cila e jep shërbimin e pagesave dërgesa në para.

Ofrues të shërbimeve për inicim të pagesës

94. Raportohet të dhënat e transaksioneve të pagesave të iniciuara nëpërmjet ofruesve të shërbimeve për inicim të pagesës. Këto transaksione nuk janë të përfshira në "transaksionet e pagesave totale të cilat përfshijnë jo-MFI", sepse ato janë të përfshira në instrumentin përkatës të pagesave i cili përdoret për transaksion.

Shërbime të tjera të pagesave

95. Të dhënat për shërbimet e tjera të pagesave paraqiten në këtë zë të cilat janë të përfshira në nenin 8 të Ligjit të Shërbimeve të Pagesave dhe Sistemeve të Pagesave, por të cilat nuk mund të shpërndahen në asnjë kategori të shërbimeve të pagesave të përfshira në këtë tabelë. Raportohen të dhëna për tërheqjen/depozitimin e parave të gatshme në sportelet e OShP-ve me përdorimin e urdhëresës për tërheqje, pra depozitimin e parave të gatshme përkatësisht, përfshirë edhe kur kartela përdoret për identifikim të paguesit.

Shërbime të tjera jo të përfshira me Ligjin e Shërbimeve të Pagesave dhe të Sistemeve të Pagesave

96. Në këtë zë paraqiten të dhëna për Shërbime të tjera jo të përfshira me Ligjin e Shërbimeve të Pagesave dhe të Sistemeve të Pagesave. Këto shërbime janë të ndara në "aprovim i llogarive me regjistrim të thjeshtë", detyrim i llogarive me regjistrim të thjeshtë" dhe "tjera Shkaku se nënkategoritë përjashtohet mes vete, numri total "Shërbime të tjera" (të cilat nuk janë të përfshira me Ligjin e Shërbimeve të Pagesave dhe të Sistemeve të Pagesave) janë shuma e nënkategorive. E njëjta vlen edhe për vlerën e transaksioneve.
97. Vetëm transaksionet pa urdhëresë të posaçme për transaksion dhe të realizuara me regjistrim të thjeshtë d.m.th pa përdorim të instrumentit tradicional të pagesave, janë të përfshirë në nënkategoritë "aprovim i llogarive me regjistrim të thjeshtë" dhe "detyrim i llogarive me regjistrim të thjeshtë".
98. Në zërin "aprovim i llogarive me regjistrim të thjeshtë" raportohet për këto lloje të transaksioneve: transkriptimi i interesit nga ofruesi i shërbimeve të pagesave (interesi pasiv), transferim i shumës së kredisë të miratuar nga llogaria e OShP-së në dobi të llogarisë së pagesave të përdoruesit të kredisë të cilën e udhëheq vet OShP-ja nëse transferimi i realizuar në bazë të kontratës për kredi është pa urdhërpagesë të posaçme, pastaj pagesë të dividendëve etj. Këto transaksione nuk përfshihen në numrin total/vlerën totale të transaksioneve me instrumente të pagesave.
99. Në zërin "detyrim i llogarive me regjistrim të thjeshtë" raportohet për këto lloje të transaksioneve: transferim i shumës së interesit nga llogaria e pagesave e përdoruesit ndaj llogarisë së ofruesit të shërbimit të pagesave (interesi aktiv), transferim i shumës së tarifës së ngarkuar në llogarinë e përdoruesit në dobi të llogarisë së ofruesit të shërbimeve të pagesave (p.sh.: tarifë për udhëheqje të llogarisë), transferim të

shumës së kështit/anuitetit të kredisë nga llogaria e pagesave e përdoruesit të shërbimeve të pagesave në llogari të ofruesit të shërbimeve të pagesave nëse me kontratën e kredisë është bërë marrëveshje për transferim të tillë, më tej për provizione, tarifa dhe të ngjashme, për transaksione individuale të pagesave, të cilat tarifohen nëpërmjet debitimit të llogarisë së përdoruesit të shërbimeve të pagesave, pa urdhëresë të përcaktuar për transaksion. Këto transaksione nuk përfshihen në numrin total/vlerën totale të transaksioneve me instrumente të pagesave. Të dhënat për këto transaksione vendosen në tabelën 4, përveç për provizionet, anëtarësimet dhe shpenzimet tjera lidhur me funksionimin me kartela, të cilat vendosen në tabelën 5, në zërin e njëjtë. Të dhënat për interesat dhe pagesën e kësteve gjatë përdorimit të kartelave kreditore nuk i nënshtrohen raportimit të statistikës së pagesave.

Transaksionet e pagesave me kartela të pagesave sipas strukturës së moshës (tabela 4.1)

100. Kjo tabelë i përfshin transaksionet e pagesave me para të gatshme në ATM dhe transaksionet e pagesave jo me para të gatshme në pajisjet terminale në vendet fizike të shitjes dhe në vendet e shitjes për e-tregti, të realizuara në shtet dhe jashtë shtetit, veçmas.
101. Të dhënat nga kjo tabelë i vendos OShP-ja e cila e emeton kartelën e pagesave.
102. Të gjitha të dhënat vendosen në këtë tabelë sipas strukturës së moshës të personave fizikë rezidentë.
103. Raportuesit në tabelë i vendosin numrin dhe vlerën e transaksioneve të realizuara gjatë vitit kalendarik për të cilin raportohet.

Transaksione të pagesave të iniciuara me mashtrim të cilat përfshijnë jo-MFI (tabela 4.2)

104. OShP-ja duhet t'i raportojë të gjitha transaksionet e pagesave të iniciuara me mashtrim nga çasti kur është zbuluar mashtrimi, nëpërmjet kundërshtimit nga përdoruesi i shërbimeve të pagesave ose pajisjeve tjera, pa marrë parasysh nëse transaksioni i pagesave i iniciuar mashtrues është shkarkuar deri në momentin e paraqitjes së të dhënave.
105. OShP-ja duhet të raportojë për transaksionet e pagesave të iniciuara me mashtrim të cilat përfshijnë jo-MFI, sipas llojeve të shërbimeve të pagesave dhe atë: transferime kreditore, debitime direkte, transaksione të pagesave të bazuara në kartela me instrumente të bazuara në kartela të cilat i emeton OShP-ja në shtet (me përjashtim të kartelave me funksion të parave elektronike), transaksione të pagesave të bazuara në kartelë me instrumente të pagesave të bazuara në kartelë të cilat i pranon OShP-ja në shtet (me përjashtim të kartelave me funksion të parave elektronike), transaksionet e pagesave me para elektronike, dërgesat në para dhe shërbime të tjera të pagesave.
106. OShP-ja (përfshirë edhe OShP-në e cila e emeton instrumentin e pagesave, nëse është e zbatueshme) duhet t'i paraqesë vetëm transaksionet e pagesave që janë të

iniciuara dhe të realizuara (dhe të pranuara, nëse është e zbatueshme). OShP-ja nuk duhet të dorëzojë të dhëna për transaksionet e pagesave, edhe pse ndoshta janë të lidhura me disa rrethana të theksuara në pikën e kaluar, nuk janë realizuar dhe nuk kanë sjellë deri në transferim të mjeteve monetare në përputhje me dispozitat nga Ligji i Shërbimeve të Pagesave dhe Sistemeve të Pagesave.

107. Gjatë raportimit për mashtrime të dërgesat në para, me ç'rast mjetet monetare transferohen nga OShP-ja e pagesit drejt OShP-së së dërgesës së parave (si pjesë e transaksionit të pagesave dërgesë në para), detyrim është i OShP-së të pagesit dhe jo e OShP-së të dërgesës së parave, t'i raportojë transaksionet e pagesave nga OShP-ja e pagesit drejt OShP-së së dërgesës të parave. Transaksionet e tilla nuk duhet t'i raportojë OShP-ja e përdoruesit (pranuesit) të transaksionit të pagesave dërgesa në para. Transaksionet e pagesave të iniciuara me mashtrim në të cilat OShP-ja dërgesa në para ka bërë transferim të mjeteve monetare nga llogaritë e pagesave personale në llogarinë e pagesave të përdoruesit, përfshirë edhe nëpërmjet procedurave për kompensim të vlerës së transaksioneve të përsëritura (procedura për rrjetëzim), duhet t'i paraqesë OShP-ja dërgesë në para.
108. Transaksionet e pagesave të iniciuara me mashtrim në të cilat OShP-ja e parave elektronike ka bërë transferim të parave elektronike në llogarinë e përdoruesit, përfshirë edhe kur OShP-ja e pagesit është edhe e pranuesit, duhet t'i paraqet OShP-ja për para elektronike. Mirëpo nëse, OShP-të janë të ndryshme, transaksioni i pagesave i iniciuar me mashtrim me para elektronike e raporton vetëm OShP-në e pagesit, me qëllim ta shmang raportimin e dyfishtë.

Transaksione të pagesave sipas llojit të pajisjes terminale të cilat përfshijnë jo-MFI (tabela 5)

109. Të dhënat nga kjo tabelë janë për transaksione të pagesave me para të gatshme dhe me jo para të gatshme në pajisjet terminale në vendet fizike të shitjes dhe në vende të shitjes në e-tregti.
110. OShP-ja i dorëzon të dhënat për të gjitha transaksionet e pagesave të cilat i kanë pranuar pajisjet terminale.
111. OShP-ja dorëzon të dhëna për të gjitha transaksionet me instrumente të pagesave të bazuara në kartela të emetuara në shtet të realizuara në pajisjet terminale jashtë shtetit.
112. Transaksionet sipas llojit të pajisjes terminale ndahen në tre kategori të ndryshme sipas rezidencës së OShP-së. Kategoritë sipas nënpikave 1 dhe 2 numërohen në anën e OShP-së e cila i pranon kartelat e pagesave, ndërsa kategoria sipas nënpikës 3 numërohet në anën e OShP-së e cila e emeton kartelën:
- transaksionet e pagesave të pajisjeve terminale, në të cilat transaksionet pranohet nga rezidentë të OShP-së, me kartela të emetuara nga rezidentë OShP;
 - transaksionet e pagesave të pajisjeve terminale, në të cilat transaksionet pranohet nga rezidentë të OShP-së, me kartela të emetuara nga jorezidentë OShP;
 - transaksionet e pagesave të pajisjeve terminale, në të cilat transaksionet pranohen nga jorezidentë të OShP-së, me kartela të emetuara nga rezidentë OShP.

Nënkategoritë e çdo kategorie të nënpikave 1, 2 dhe 3 nga kjo pikë nuk mbliidhen.

113. Në këtë tabelë shpërndarja gjeografike është bërë nga aspekti i shtetit në të cilën është vendosur pajisja terminale, si dhe nga aspekti i shtetit në të cilën është emetuar kartela të pagesave.
114. Të dhënat analitike nga kategoria b) shfaqen vetëm në kolonat për numër dhe vlerë të transaksioneve ndërmjet ofruesve të realizuara nga ana e personave fizikë (në këtë kolonë përfshihen edhe transaksionet e realizuara nga personat juridikë shkaku pamundësisë të bëhet dallimi mes personave fizikë dhe juridikë nga aspekti i pronësisë së kartelës së pagesave jashtë shtetit). Të dhënat analitike nga kategoria c) shfaqen në kolonat përkatëse për numrin dhe vlerën e transaksioneve ndërmjet ofruese të personave fizikë dhe juridikë.
115. Transaksionet e pajisjes terminale POS (me përjashtim të transaksioneve me para elektronike) i përfshijnë edhe transaksionet e realizuara në imprinterat. Transaksionet e pajisjes terminale POS (me përjashtim të transaksioneve me para elektronike) e përfshijnë nënkategorinë: "transaksione të iniciuara në pajisjet terminale EFTPOS (me përjashtim të transaksioneve me para elektronike)". Kjo nënkategori më tej ndahet në transaksione të realizuara në pajisjet terminale të cilat pranojnë pagesa pa kontakt.
116. Në normën "depozitim të parave të gatshme në sportelet e ofruesve të shërbimeve të pagesave" përfshihet depozitimi i parave të gatshme në llogari në kasafortën për depozita ditore ose nate për aprovimin e llogarisë të OShP-ja.
117. Zëri "tërheqje e parave të gatshme në sportelet e ofruesit të shërbimeve të pagesave" nuk paraqet pagesë në kuptim të vërtetë, por përfshin vetëm ndryshim nga mjetet monetare në llogarinë e pagesave në para të gatshme.
118. "Transaksionet e pagesave me para elektronike me kartela me para elektronike", i përfshijnë transaksionet me kartelat në të cilat mundet direkt të ruhen paratë elektronike dhe kartela të cilat mundësojnë qasje deri te paratë elektronike të cilat ruhen në llogarinë e parave elektronike.
119. "Tërheqje e parave të gatshme në pajisjet terminale POS", me ç'rast nuk ekziston mundësi të dallimit të të dhënave për tërheqjen e parave të gatshme në pajisjet terminale në vendet fizike të shitjes, raportohen në zërin "transaksione në pajisjet terminale POS".
120. Tabela 5, më tutje, ndahet në dy nëntabela: tabela 5.1 dhe tabela 5.2 të cilat përmbajnë të dhëna për numrin, ose vlerën e transaksioneve të realizuara me kartela të pagesave sipas pajisjeve terminale, sipas skemës së kartelave të pagesave.

Pjesëmarrje në sistemet e pagesave (tabela 6)

121. Tabela përfshin numrin dhe llojin e pjesëmarrësve në sistemin e pagesave dhe raportohet nga operatori i sistemit të pagesave.
122. Zëri "numri i pjesëmarrësve" është shuma e dy kategorive që përjashtojnë njëra tjetrën "pjesëmarrës direkt" dhe pjesëmarrës indirekt".

123. Zëri "pjesëmarrës direkt" është shuma e tre kategorive që përjashtojnë njëra tjetrën: "banka dhe kursimore", "Banka Popullore" dhe "pjesëmarrës tjerë direkt".
124. Zëri "pjesëmarrës direkt" është shuma e pesë kategorive që përjashtojnë njëra tjetrën: "institucione të qeverisjes shtetërore", operatorë të sistemeve të pagesave" dhe "operatorë të sistemeve për shlyerje të letrave me vlerë", "institucione të tjera financiare" dhe "tjera".

Pagesat e përpunuara nëpërmjet sistemeve të pagesave (tabela 7)

125. Tabela i përfshin transaksionet e pagesave të përpunuara nga sistemi i pagesave.
126. Transaksionet e pagesave të OShP-ve në llogari të tij raportohen në zërin përkatës në këtë tabelë.
127. Nëse në kuadër të një sistemi të pagesave bëhet shlyerje e transaksioneve nga sistemi tjetër i pagesave, në atë rast aplikohen këto parime:
- sistemi i pagesave në të cilin bëhet shlyerja e paraqet numrin dhe vlerën e transaksioneve të cilat janë shlyer;
 - nëse kliringu i transaksioneve të pagesave realizohet jashtë sistemit të pagesave dhe në kuadër të sistemit të pagesave realizohet vetëm shlyerja e neto-pozitave, numërohen vetëm transaksionet e shlyerjes së neto-pozitave dhe për ato raportohet në përputhje me shërbimin e pagesave e cila shlyhet me atë transaksion.
128. Çdo transaksion të pagesave numërohet një herë në anën e pjesëmarrësit i cili dërgon d.m.th. Detyrimi i llogarisë së pagesit dhe aprovimi i llogarisë së pranuesit nuk numërohen veçmas.
129. Në rast të transaksioneve në skedar/grup çdo transaksion numërohet veçmas.
130. Te sistemet e pagesave të cilat bëhet rrjetëzim, paraqiten numri dhe vlera e transaksioneve të pagesave në bazë bruto dhe jo rezultati nga rrjetëzimi.
131. Çdo sistem i pagesave paraqet të dhëna nga transaksionet e realizuara në përgjithësi dhe për çdo pjesëmarrës veçmas.
132. Sistemi i pagesave i dorëzon të dhënat për numrin dhe vlerën e transferimeve kreditore, debitimeve direkte, transaksioneve të pagesave të bazuara në kartela, transaksionet e realizuara nëpërmjet ATM-ave dhe transaksioneve me para elektronike, duke i përkufizuar në transaksione të realizuara në shtet dhe jashtë shtetit. Transaksionet e pagesave të anuluar nuk përfshihen. Transaksionet të cilat më vonë refuzohen nuk përfshihen. Transaksionet e anuluar në shumë totale ose të pjesshme, të cilat nënkuptojnë transferim të mjeteve financiare mes llogarive të pagesave, gjithashtu duhet të përfshihen në periudhën kur është realizuar anulimi dhe ato nuk kanë parashenjë negative.
133. Numri dhe vlera e transaksioneve të realizuara nëpërmjet "pagesave instant" paraqiten si nënkategorie e "Transferimeve kreditore" të realizuara nga ana e

raportuesit. Nëse ekzistojnë më shumë skema të pagesave instant, raportimi bëhet për çdo skemë të pagesave instant, veçmas.

Tarifat dhe vlera totale e transaksioneve të pagesave të realizuara me kartela të pagesave në vende të shitjes (tabela 8.1)

134. Tabela i përfshin të dhënat për tarifat në % dhe në denarë të cilat tarifohen nga tregtarët varësisht nga lloji dhe veprimtaria e tregtarit dhe vlera totale e transaksioneve të pagesave të realizuara me kartela të pagesave në vendet e shitjes dhe sipas brendeve të pagesave të kartelave të cilat tregtari i paguan OShP-së, sipas skemave të kartelave dhe llojit të veprimtarisë së tregtarit.
135. Raportuesi i vendos të dhënat e tarifave në % dhe të vlerës totale në denarë të transaksioneve të pagesave të realizuara me kartela të pagesave në vendet e shitjes varësisht nga lloji i veprimtarisë së tregtarit, skema e kartelave të pagesave dhe intervalet e përcaktuara të vlerës totale të transaksioneve të pagesave në denarë gjatë vitit kalendarik për të cilin raportohet.
136. Gjatë ekzistimit të tarifimeve të ndryshme të tregtarët nga veprimtaria njëjtë, të cilat i takojnë intervaleve të njëjta të vlerës totale të transaksioneve të pagesave në denarë, raportuesi raporton për tarifimin mesatar të ponderuar duke e përdorur si ponder vlerën totale të transaksioneve të pagesave në denarë të realizuara me kartela të pagesave të tregtari gjatë vitit kalendarik për të cilin raportohet.
137. Gjatë ekzistimit të veprimtarive të ndryshme të një tregtar, raportuesi raporton veçmas për tarifimin dhe vlerën totale të transaksioneve të pagesave nga çdo veprimtari, në llojet e veprimtarive përkatëse.
138. Nëse raportuesi nuk ka tregtarë të cilët karakterizohen në veprimtaritë e theksuara dhe/ose intervaleve të vlerës totale të transaksioneve të pagesave në denarë gjatë vitit kalendarik për të cilin raportohet, fushat mbesin të zbrazëta.
139. Tarifat e pagesave në këste për mallrat dhe shërbimet nuk paraqiten në tabelën nr. 8.1.

Shuma e tarifave të cilat i tarifon ofruesi i shërbimeve të pagesave nga mbajtësi i kartelës së pagesave (tabela 8.2)

140. Tabela i përfshin të dhënat për shumën e kompensimeve të cilat mbajtësit e kartelave të pagesave (persona fizikë dhe juridikë) i paguajnë OShP-së për mbajtje dhe përdorim të kartelës së pagesave në pajisjet terminale në vendet e shitjes dhe ATM-ave, të kufizuara në persona fizikë dhe juridikë, sipas skemave të kartelave të pagesave dhe kartelave debitore dhe kreditore.
141. Për zërin "anëtarësim" raportuesi raporton për shumën e tarifës së llogaritur në denarë, i llogaritur si raport i të ardhurave totale nga anëtarësimi në vitin kalendarik për të cilin raportohet dhe gjendja mesatare e numri të kartelave në qarkullim (numri mesatar i kartelave llogaritet nga gjendja në fund të çdo muaji në vitin kalendarik për të cilin raportohet), për secilën nga kategoritë e theksuara në tabelën.

142. Për artikujt të cilat kanë të bëjnë me tarfin gjatë tërheqjes dhe depozitimit të parave të gatshme raportuesi raporton për tarifën në %. Njëkohësisht, gjatë ekzistimit të normave të ndryshme të tarifës të një lloji i caktuar i kartelës nga secila kategori, raportuesi raporton për tarifën mesatare të ponderuar në % për çdo kategori, duke e përdorur si vlerën e ponderuar totale të transaksioneve të realizuara, e llojin konkret të kartelës gjatë vitit kalendarik për të cilin raportohet.
143. Për kategorinë "tarifë për kontrollim të gjendjes në llogari" raportuesi e vendos shumën mesatare të tarifës në denarë, të llogaritur si raport nga të ardhurat totale nga transaksionet për kontrollim të llogarisë së pagesave dhe numrin total të transaksioneve për kontrollim të llogarisë në vitin kalendarik për të cilin raportohet, për secilën nga kategoritë e theksuara në tabelë.

Tarifa e zëvendësimit mes ofruesve të shërbimeve të pagesave dhe tarifa e skemës së kartelës së pagesave gjatë transaksioneve të pagesave të bazuara në kartela (tabela 8.3)

144. Të dhënat janë të ndara për secilin nga brendet e pagesave me të cilat shënohet instrumenti i pagesave i bazuar në kartela që e emeton OShP-ja dhe i cili përdoret për realizimin e transaksioneve të pagesave të bazuara në kartela të pagesave për të cilat llogaritet dhe paguhet tarifë zëvendësuese në përputhje me dispozitat sipas nenit 115 të Ligjit të Shërbimeve të Pagesave dhe Sistemeve të Pagesave.
145. Në kolonën "Lloji i kartelës së pagesave" vendoset një nga këto shenja: debitore/kreditore varësisht nga lloji i instrumentit të pagesave të bazuar në kartela për të cilin janë të dhënat.
146. Në kolonën "Numri total i transaksioneve në vendet e shitjes" shfaqet numri total i transaksioneve të pagesave në vendet e shitjes, përfshirë edhe vendet e shitjes për e-tregti, të cilat janë të realizuara me kartela të pagesave të emetuara nga OShP-ja rezidente (dhe atë për një brend të caktuar në tërësi, si dhe për një lloj të caktuar kartelës së pagesave nga ai brend). Nuk përfshihen transaksionet e pagesave me kartelat e pagesave afariste, transaksionet e pagesave të pranuar nga jorezidentë OShP dhe transaksionet e pagesave të cilat OShP-ja njëkohësisht e emeton kartelën dhe e pranon pagesën (ang.: on-us transactions).
147. Në kolonën "Vlera totale e transaksioneve të pagesave në vendet e shitjes" shfaqet vlera totale e transaksioneve të pagesave të bazuara në kartelë të emetuara nga OShP-ja (dhe atë për një brend i pagesave në tërësi, si dhe për një lloj të caktuar të kartelës nga ai brend) me ç'rast për këtë shumë paraqet totalin e të gjitha transaksioneve të pagesave numri i së cilave është shfaqur në përputhje me shtrirjen nga pika 146 e këtij udhëzimi.
148. Në fushën "Shuma totale e tarifës së paguar nga OShP-ja e cila e pranon pagesën" shfaqet shuma totale e tarifave të zbatuara nga OShP-ja e cila e pranon pagesën e transaksioneve të pagesave të realizuara me përdorimin e kartelave të OShP-së emetuese (dhe atë për një numër të caktuar të brendit të pagesave në tërësi, si dhe për një lloj të caktuar të kartelës së pagesave nga ai brend), me ç'rast kjo shumë

paraqet totalin e shumës së të gjitha tarifave të pranuar nga OShP-ja e cila e pranon pagesën e transaksioneve të pagesave numri i së cilëve është shënuar në pikën 146.

149. Në kolonën "Fonde dhe stimuj të pranuar" shfaqet shuma totale e mjeteve të pagesave, zbritjet ose llojet tjera të stimujve të cilat OShP-ja, e cila e emeton instrumentin e pagesave, i ka pranuar dhe në rolin e OShP-së e cila e emeton instrumentin e pagesave dhe në rol të OShP-së e cila pranon nga skemat e kartelave të pagesave, OShP-ja e cila i pranon pagesat ose nga çdo tjetër ndërmjetësues në lidhje me të gjitha transaksionet e pagesave të bazuara në kartela të një brendi të caktuar të pagesave, si dhe të gjitha aktivitetet tjera të lidhura, me ç'rast stimujt i përfshijnë të gjitha format e mundshme të stimulimit të marketingut, mbështetje për produktet e reja (ang. project support), shtesa për vëllimin e realizuar të transaksioneve (ang. incremental support), shtesa për vëllim të realizuar të transaksioneve (ang. incremental volume) dhe tjera.

150. Në kolonën "Fonde dhe stimuj të dhëna" shfaqet shuma totale e mjeteve të pagesave të dhëna ku OShP-ja, e cila e emeton instrumentin e pagesave, i ka dhënë skemave të kartelave të pagesave lidhur me ato transaksione të pagesave të bazuara në kartela të një brendi i pagesave të caktuar, si dhe me gjitha aktivitetet e tjera.

151. Në kolonën "Neto-kompensime" shfaqet shuma totale e neto-kompensimeve të marra nga dallimi i pranimeve dhe dhënieve totale të shfaqura në përputhje me pikën 149 dhe 150 të këtij udhëzimi.

VI. STANDARDE GJATË RAPORTIMIT

152. Raportuesit janë të detyruar t'ju përmbahen këtyre standardeve gjatë raportimit:

152.1 Standardet të cilat kanë të bëjnë me transferimin e të dhënave:

- të dhënat duhet të dorëzohen në afatin e përcaktuar me Vendimin dhe i përmbajtjen, mënyrën, formën dhe afatet e dorëzimit të të dhënave dhe informacioneve të statistikës së pagesave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 6p.12/23);
- të dhënat duhet të jenë në format që është përkatës me kërkesat teknike të raportimit në përputhje me instruksionet e dorëzimit të të dhënave në mënyrë elektronike (më tutje në tekst: instruksionet);
- raportuesit gjatë shfaqjes së të dhënave duhet t'u përmbahen standardeve të transferimit teknik të të dhënave të përcaktuara me instruksionet.

152.2 Standardet të cilat kanë të bëjnë me saktësinë e të dhënave:

- të dhënat e dorëzuara duhet të jenë të barabarta me të dhënat vërteta të raportuesit;
- raportuesi duhet t'u përmbahet rregullave të rrumbullakimit të numrave në përputhje me instruksionet.

152.3 Standardet të cilat kanë të bëjnë me përshtatshmërinë e të dhënave:

- raportuesi duhet të caktojë person/persona për kontakt për secilin nga raportet, të cilat duhet të përditësohen në bazë të rregullt.

152.4 Standardet të cilat kanë të bëjnë me përmirësimin e të dhënave të dorëzuara:

- raportuesit duhet t'u përmbahen rregullave dhe procedurave të përmirësimit të gabimit të të dhënave të dorëzuara;
- përmirësimi i gabimit bëhet më së voni në ditën e dhjetë të ditës së punës, llogaritur nga afati i fundit i dorëzimit të të dhënave;
- raportuesit të cilët devijojnë nga afatet e përcaktuara kohore për përmirësim të gabimit, duhet të dorëzojnë shpjegim me shkrim për arsyet e devijimit të të dhënave, pra të dorëzojnë dëshmi (arsyetim) për verifikim të saktësisë së të dhënave të cilat devijojnë nga vlerat e pritura.

VII. MËNYRA E DORËZIMIT TË TË DHËNAVE DHE RISHIKIMI I TYRE

153. Të dhënat e përkufizuara në tabelat dorëzohen në mënyrë elektronike në përputhje me aktin nënligjor që rregullon lidhjen me sistemin informativ të Bankës Popullore.

154. Rishikimi i të dhënave të publikuara bëhet në rast të:

- marrjes së informacioneve të reja, të korigjuara dhe të dhëna nga raportuesit; ose
- ndryshime metodologjike në terminologji dhe përkufizimet. Rishikimi i të dhënave në serinë historike kohore bëhet duke filluar nga momenti i ndodhjes së ngjarjes që ka çuar në ndryshimin e të dhënave.

VIII. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

155. Raportuesit janë të detyruar t'i dorëzojnë të dhënat mujore nga tabelat e periudhës raportuese e cila fillon në janar të vitit 2024, ndërsa të dhënat vjetore nga periudha raportuese e cila fillon në janar të vitit 2024 në përputhje me kalendarin e publikimit të të dhënave nga fusha e statistikës së pagesave.

Me përjashtim të paragrafit 1 të kësaj pike, raportuesit janë të detyruar t'i dorëzojnë të dhënat nga tabela për llogaritë e pagesave me funksione bazë dhe për llogaritë joaktive për çdo muaj kalendarik të 2023, si dhe të dhënat vjetore nga tabelat 4.2 dhe 8.3 për 2023 më së voni deri 25 janar 2024.

156. Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, ndalon së vlejtori Udhëzimi për dorëzimin e të dhënave dhe informacioneve për statistikën pagesore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 116/23).

157. Ky vendim hyn në fuqi tetë ditë pas botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe do të zbatohet nga 1 janari 2024.

U nr. 02-32621/1
3 Oktomvri 2023
Shkup

Guvernatorja
д-р Анита Ангеловска-Бежоска